



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 01 / 1431 Dt. 28 / 07 / 2023

Në bazë të nenit 28, paragrafi 1, nënparagrafi 1.19 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, dhe nenit 33 paragrafi 1 i Ligjit të Punës dhe në koordinim me Sekretarin e përgjithshëm të UKZ-së, marr këtë:

V E N D I M

**për shfrytëzimin e pushimit vjetor për personelin akademik dhe administrativ të
Universitetit Publik "Kadri Zeka" për vitin 2023**

1. Pushimi vjetor për personelin akademik të pesë (5) njësive akademike të UKZ-së, nga data 01.08.2023 deri më 31.08.2023.
2. Pushimi vjetor për personelin administrativ të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan do të shfrytëzohet nga data 01.08.2023 deri më 28.08.2023.
3. Kthimi në punë nga pushimi vjetor për nëpunësit administrativ bëhet me datë 29.08.2023.
4. Pushimi vjetor mund të shfrytëzohet deri me 30 Qershor të vitit të ardhshëm, në dy (2) apo më shumë pjesë për nëpunësit të cilët përveç pushimit vjetor kanë edhe ditë pushimi të fituar nga përvoja e punës.
5. Zyra e financave, prokurimit, TI-së, Zyra e Shërbimit të studentëve dhe nëpunësit tjerë gjatë periudhës së pushimit do t'i kryejnë vetëm shërbimet esenciale. Udhëheqësit e zyrave përkatëse, janë të obliguar që gjatë kohës së pushimit vjetor të caktojnë sipas nevojës një nëpunës i cili do ti kryej shërbimet esenciale, ndërsa nëpunësit obligohen që të mbajnë evidencë për ditët e punës dhe një raport të punës, për këtë paraprakisht duhet të njoftohet me email ZKA-ja dhe Menaxherja e personelit dhe pa aprovim nga ZKA-a nuk ju kompensohet dita e daljes si ditë pushimi vjetor.

6. Zyra për diploma gjatë kohës së pushimit vjetor do të punojë një ditë në javë sipas njoftimit nga zyrtari i diplomave i cili do t'i kryej shërbimet e dhënies së diplomave të nënshkruara nga personat e autorizuar, ndërsa nëpunësit obligohen që të mbajnë evidencë për ditët e punës.
7. Menaxheri i personelit, obligohet që për secilin nëpunës administrativ të UKZ-së të lëshojë vendim individual për periudhën e shfrytëzimit të pushimit vjetor për vitin 2023.
8. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.



Prof. Dr. Bajram Kosumi

Rektor i UKZ-së

Vendimi t'i dërgohet:

1. Menaxhmentit të UKZ-së;
2. Sekretarit të përgjithshëm të UKZ;
3. Drejtorëve të shërbimeve ;
4. Menaxherit të personelit të UKZ
5. Publikohet në www.uni-gjilan.net